



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesja **Klea Gjata** më datë **19.06.2024** dhe kërkuesja **Shaqe Gjata** më datë **08.07.2024** kanë paraqitur pranë Gjykatës kërkesat me objekt: “Kthimin e sendit të sekuestruar sipas procesverbalit të datës 01.10.2023, ora 17:55, mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Elbasan, z.K.Sh” (bashkuar këto kërkesa në një të vetme në seancën gjyqësore të datës 10.07.2024).

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, bazuar në nenet 190, 217, 218 dhe 379 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **377**, datë **22.07.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës të paraqitur nga kërkuesja **Shaqe Gjata**.
2. Kthimin e sendeve të sekuestruara nëpërmjet procesverbalit “Për sekuestrimin e sendeve”, të datës 01.10.2023 konkretisht: automjeti tip **Mercedes – Benz, me targa ******, me ngjyrë të zezë, në pronësi të shtetases Shaqe Gjata, së bashku me dokumentacionin e mjetit, duke iu lënë në ruajtje shtetases Shaqe Gjata deri në përfundim të gjykimit.
3. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Rrëzimin e kërkesës të paraqitur nga shtetësja **Klea Gjata**.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve**, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 22.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar